FONDACIONI

Rexhep Stafa

LEGALIZIMI I KANABISIT NË SHQIPËRI:

Përfitimet dhe Risqet

Qershor 2022

Studimi “Legalizimi i Kanabisit në Shqipëri: Përfitimet dhe Risqet” është përgatitur me mbështetjen e WFD - Westminster Foundation for Democracy.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqëson detyrimisht pikëpamjet e Fondacionit Qemal Stafa. Fondacioni ka të drejtat e plota të këtij raporti, i cili nuk mund të riprodhohet ose përkthehet i gjithë ose një pjesë e tij pa konfirmim paraprak.

Ekspertët:
Klodian Gjermeni
Fjona Kurteshi

Qershor 2022

Tabela e Përmbajtjes

1. Iniciativa për Legalizimin e Kanabisit në Shqipëri 1

2. Qasjet Politike dhe Modelet e Prodhimit dhe Përdorimit të Drogës 2

3. Rregullimi Institucional dhe Ligjor në Botë 5

4. Rregullimi Institucional dhe Ligjor në Shqipëri 7

5. Analiza të Situatave në Tërësi në Vende të Tjera që e Kanë Legalizuar Procesin më Parë 10

6. Analiza e Situatës në Shqipëri 13

7. Përfitimet dhe Risqet e Mundshme që Vijnë nga Legalizimi i Kanabisit për Arsye Mjekësore në Shqipëri 16

8. Gjetjet Kryesore 17

Referenca 18

Aneks 20

1. Iniciativa për Legalizimin e Kanabisit në Shqipëri

Një numër në rritje vendesh anembanë botës po ndryshojnë politikat lidhur me prodhimin dhe përdorimin e drogës duke i dhënë fund ngarkimit me pergjegjësi penale për individet që përdorin ose posedojnë drogë dhe deri në legalizimin e tij për qëllime të ndryshme përdorimi. Rosmarin et al (2012), tregojnë që politikat e dekriminalizimit nuk janë një fenomen i ri për disa vende, si për shembull Spanja ka pasur një qasje jo-kriminale ndaj përdorimit të drogës që në vitin 1970. Në vende të ndryshme të botës gjithashtu po vërehet një tendencë në rritje e numrit të qytetarëve të cilët janë pro legalizimit të kanabisit, akoma më tepër kur bëhet fjalë për arsye mjekësore dhe veçanërisht te moshat e reja.

Në Shqipëri që prej fillimit të viteve 1990 prodhimi dhe shpërndarja e kanabisit është shndërruar në një treg të qëndrueshëm ilegal ku së bashku me aktivitetet e tjera ilegale dhe informale përbëjnë rreth 30-40% të PBB-së. Në vijim të nismës së Këshillit Kombëtar të Qeverisë Shqiptare, ku nëpërmjet një pyetësori mbi çështje me rëndësi strategjike për vendin, ekonominë e shoqërinë u zhvillua një kuvendim popullor, qytetarëve u është drejtuar pyetja nëse janë pro, apo jo legalizimit të kanabisit për qëllime mjekësore. Nisma e qeverisë ka nxitur debate ndërmjet grupeve të shumta të interesit për shkak edhe të zhvillimit që ka kultivimi dhe shpërndarja e kanabisit në vend nga grupet e organizuara kriminale, pavarësisht "luftës" së vazhdueshme me qeverinë, por edhe me forcat policore të vendeve fqinje.

Në të gjithë botën, interesi i kompanive farmaceutike për të përfshirë kanabisin për trajtime mjekësore është rritur. Sipas parashikimeve të New Frontier Data, vlera globale e kanabisit për qëllime mjekësore pritet të arrijë në 46 miliardë dollar deri në vitin 2030 duke krijuar kështu mundësi për tregje të reja të legalizuara dhe fitime të larta. Pavarësisht eksperiencës në tregtimin e kanabisit, formalizimi i tregut do të shoqërohet me sfida të mëdha. Krijimi i strukturave të duhura rregullative, fenomeni i korrupsionit dhe kepërdorimi i licencave janë problemet që ekspertët parashtrojnë në argumentet e tyre kundër legalizimit të kanabisit.

Të kuptuarit e llojeve të qasjeve politike, si dhe modeleve që përdoren nga qeveritë lidhur me prodhimin dhe përdorimin e drogës merr rëndësi të veçantë në një moment kur Shqipëria është në një fazë konsultimi për legalizimin e kanabisit, apo jo. Ky punim pasqyron në mënyrë të përmbledhur historinë e prodhimit dhe shpërndarjes së paligjshme të kanabisit që prej disa dekadash tashmë në Shqipëri, si një vatër për tregun evropian dhe me gjerë. Gjithashtu, pamje merren edhe nga vende të tjera të botës dhe ato më afër rajonit, të cilat kanë kaluar procesin e legalizimit më parë. Punimi synon ndër të tjera të identifikojë përfitimet dhe risqet e mundshme që vijnë nga ky model legalizimi i kanabasit në Shqipëri.

[1] https://www.kryeministria.al/newsroom/kryeministri-rama-komunikon-nismen-e-re-te-keshillimit-kombetar-per-shqiperine/

2. Qasjet Politike dhe Modelet e Prodhimit dhe Përdorimit të Drogës

Kanabis është termi i përdorur për një gjini bimësh me lule brenda familjes Kanabaceae, i konsideruar drogë narkotike. Kjo gjini përfshin rreth 170 lloje të ndryshme bimore, të cilat ndahen në kategoritë e Kanabis Ruderalis, Kanabis Sativa dhe Kanabis Indica. Marijuana dhe kërpi janë dy nga bimët më të njohura, të cilat konsiderohen si bimë kanabisi, megjithëse janë lloje të ndryshme brenda së njëjtës familje dhe kanë disa karakteristika të veçanta.

Kur bëhet fjalë për kërpin kundër marijuanës, të dy kanë aplikime shumë të ndryshme. Marijuana është e vetmja bimë që përmban THC (tetrahydrocannabinol), i cili është kanabinoidi përgjegjës për ekzaltimin e personave që e konsumojnë atë. Marijuana përmban gjithashtu CBD (kanabidiol), një tjetër kanabinoid i njohur që nuk çon në ekzaltim, por ka shumë efekte të dobishme mjekësore të raportuara, të tilla si lehtësim dhimbjeje dhe relaksim. Lloje të ndryshme të marijuanës kanë përqendrime të ndryshme të CBD-je dhe THC-je, duke çuar në efekte të ndryshme kur konsumohen. Kërpi, nga ana tjetër, përmban CBD dhe jo THC ose THC në sasi shumë të ulëta. Është gjithashtu një nga materialet ndërtimore më të dobishme në botë, me potencialin për të bërë litar, veshje, letër dhe shumë më tepër (DEA, 2020).

Shumica e marijuanës e përdorur për arsye mjekësore është më e lartë në përqëndrimin e CBD-së sesa të THC-së për të shmagur efektet psikoaktive, të tilla si ndjesia e euforisë ose halucinacione (Bloom, A., 2018). Në fakt, sipas artikullit të Desjardins, J. (2019), përdorimi i kanabisit për arsye mjekësore është një fenomen i hershëm, i cili ka filluar qysh para 6000 vitesh në fshatin Pan-p'o të Kinës, ku kanabisi konsiderohej si një nga "pesë drithërat" dhe kultivohej si një kulturë kryesore ushqimore. Regjistrimi më i hershëm i kanabisit si drogë mjekësore ishte kur perandori Shen-Nung njohu vetitë e tij kuruese për mbi 100 sëmundje si epilepsia, reumatizma dhe malaria. Marijuana vazhdoi të përdoret për vetitë e saj mjekësore për mijëra vjet dhe u bë shumë e diskutueshme në Shtetet e Bashkuara në fillim të viteve 1900.

Kur flasim për kanabisin dhe legalizimi e tij, duhet të mbajmë në konsideratë që dekriminalizimi dhe legalizimi janë dy koncepte të ndryshme. ADF (2019) i përkufizon termat si më poshtë:

Dekriminalizimi nënkupton heqjen e dënimit penal për posedimin e kanabisit. Mund të zëvendësohet me një akuzë civile, ose një gjobë në vend, por nuk merret rekord apo burg për kanabisin.

Legalizimi nënkupton lejimin e shitjes dhe konsumit të kanabisit si produkt i ligjshëm, që i nënshtrohet një forme rregullimi, i ngjashëm me alkoholin, duhanin ose produktet farmaceutike dhe që mund të marrë forma të ndryshme.

Nëse një qeveri vendos të legalizojë kanabisin, ajo duhet gjithashtu të përcaktojë se si do të rregullohet legalizimi, duke filluar nga përcaktimi ligjor se kush mund ta blejë dhe shesë atë,

në cilat forma, me cilin çmim dhe a mund ta kultivojnë njerëzit vetë. Dallohen dy lloje kryesore të legalizimit të kanabisit: legalizimi për përdorim vetjak dhe legalizimi për përdorim mjekësor.
Legalizimi për përdorim vetjak, njohur ndryshe me termin përdorim rekreativ, është kur kanabisi përdoret për vetitë e tij të këndshme. Këtu, lulja (ose sythi) e kanabisit tymoset ose konsumohet në ushqime, të tilla si kek apo ëmbëlsira.
Legalizimi i kanabisit për përdorim mjekësor është kur përdorimi i tij ka për qëllim të trajtojë ose të ndihmojë në trajtimin e një gjendjeje mjekësore. Ky shpesh mund të jetë një preparat farmaceutik i kontrolluar (si vaj ose llak) në vend të lules (sythit) të kanabisit (bimor).
Përsa i përket legalizimit për përdorim vetjak, ekzistojnë dy modele:

- ***Modeli komercial*** - Disa shtete amerikane për shembull, si Kolorado, e kanë adoptuar këtë model. Dyqanet e pavarura shesin një gamë të gjerë produktesh, nga lulja "tradicionale" e kanabisit deri te ëmbëlsirat e ngrënshme, pijet e gazuara e deri te koncentratet. Konkurrenca i shtyn kompanitë të krijojnë paketime tërheqëse dhe marka të sofistikuara, si dhe variacione krijuese të produkteve. Ky është një avantazh i madh për sipërmarrësit dhe të ardhurat nga taksat e shtetit. Megjithatë, nga pikëpamja e shëndetit publik, kjo paraqet disa probleme.
- ***Modeli jo komercial*** - Qeveritë gjithashtu mund të zgjedhin të mbajnë më shumë kontroll mbi prodhimin dhe shitjen e kanabisit. Në Uruguaj, për shembull, kanabisi blihet përmes farmacive, ka një kufi për sa mund të blihet në muaj, dhe vetëm qytetarët dhe banorët rezidentë mund të blejnë kanabis ose të rritin bimët e tyre. Ky model mund të ndihmojë në bërjen e kanabisit më "të mërzitshëm" dhe të ketë më pak gjasa të tërheqë përdorues të tjerë dhe të rinj në moshë.

Lidhur me legalizimin e kanabisit për përdorim mjekësor, duhet dalluar nëse shteti lejon prodhimin e kanabisit me qëllim shitjeje ose eksporti për firmat përpunuese të tij, apo nëse shteti lejon pacientë të cilësuar me kushte mjekësore terminale ose të dobëta, të cilët, sipas gjykimit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor, mund të përfitojnë nga përdorimi mjekësor i kanabisit, nuk do të arrestohen, ndiqen penalisht ose të jenë subjekt i sanksioneve të tjera penale ose pasojave civile sipas ligjit të shtetit bazuar vetëm në të shtetit bazuar vetëm në përdorimin e tyre mjekësor të kanabisit, pavarësisht nga çdo dispozitë tjetër ligji. Sipas FindLaw (2021), shpesh në legalizimin e kanabisit për përdorim mjekësor, disa përjashtime bujqësore për kultivimin e vazove përfshihen në ligj. Kjo është e rëndësishme sepse nëse do të ishte ende e paligjshme rritja e kanabisit ose furnizimi i një dyqani/farmacie me të, atëherë një pacient i sëmurë do të kishte vështirësi në marrjen e drogës.

Vlen të theksohet se, nga këndvështrimi mjekësor, ka një debat për përdorimin e kanabisit për terapi të ndryshme, pasi përkrahësit dhe kundërshtarët e kanabisit mjekësor kanë arsye të vlefshme për të mbështetur besimet e tyre.

Ligjshmëria e kanabisit për përdorim mjekësor dhe rekreativ ndryshon sipas vendit, për sa i përket posedimit, shpërndarjes dhe kultivimit të tij, dhe (për sa i përket mjekësisë) se si mund të konsumohet dhe për çfarë kushtesh mjekësore mund të përdoret. Këto politika në shumicën e vendeve rregullohen nga tre traktate të Kombeve të Bashkuara: Konventa e Vetme e 1961 mbi Drogat Narkotike, Konventa e 1971 mbi Substancat Psikotropike dhe Konventa e 1988 Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotropike (Roojin, H. et al, 2018 dhe David, B-T. et al, 2016).

Përdorimi i kanabisit për qëllime rekreative është i ndaluar në shumicën e vendeve, ku disa vende aziatike dhe të Lindjes së Mesme kanë dënime me disa vite burgim edhe për posedime në sasi të vogla. Megjithatë, shumë vende të tjera të botës kanë miratuar një politikë të legalizimit për përdorim rekreativ, të tilla si Kanadaja, një pjesë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gjeorgjia, Malta, Meksika, Afrika e Jugut, Uruguai, Distrikti i Kolumbisë, Territori i Kryeqytetit Australian në Australi. Një politikë e zbatimit të kufizuar është miratuar gjithashtu në shumë vende, veçanërisht në Holandë ku shitja e kanabisi tolerohet në kafenetë e licencuara (Kwai, I., 2020 dhe Powell, B., 2018). Vendet që kanë legalizuar përdorimin mjekësor të kanabisit përfshijnë një pjesë të madhe të shteteve në Amerikën e Veriut dhe atë të Jugut, në Australi, vetëm pak shtete në Afrikë

[2] Sëmundja terminale ose sëmundja e fazës përfundimtare është një sëmundje që nuk mund të kurohet ose trajtohet në mënyrë adekuate dhe që në mënyrë të arsyeshme pritet të rezultojë në vdekjen e pacientit.

dhe në Azi, si dhe disa shtete evropiane, përfshirë këtu vende të BE-së (Bashkimit Evropian) si Kroacinë, Qipron, Republikën Çeke, Danimarkën, Finlandën, Gjermaninë, Greqinë, Irlandën, Italinë, Lituaninë, Letoninë Luksemburgun, Maltën, Holandën, Poloninë, Portugalinë, dhe vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor, si Maqedoninë e Veriut.

3. Rregullimi Institucional dhe Ligjor në Botë

Që nga viti 2001, Zyra e Kanabisit Mjekësor (OMC) ka qenë agjencia qeveritare e Holandës me monopolin e furnizimit me kanabis mjekësor për farmacitë dhe mjekët e përgjithshëm në përputhje me kushtet e Konventës së Kombeve të Bashkuara (KB) të vitit 1961. Prodhuesit janë të licencuar nga qeveria holandeze dhe duhet t'ia shesin të gjitha produktet OMC-së, e cila më pas i'a shpërndan farmacive. OMC ofron varietete të kanabisit mjekësor, me nivele të ndryshme të THC-së (që variojnë nga më pak se 1% në afërsisht 22%) dhe CBD-së (duke filluar nga më pak se 1% në afërsisht 9%). Këto produkte plotësojnë nevoja të ndryshme pacientësh me një kosto prej rreth 45 euro për 5 gramë. Këto mund të përshkruhen për lehtësimin e simptomave që lindin nga skleroza e shumëfishtë, HIV/AIDS, kanceri, dhimbjet neurogjenike afatgjatë dhe tikat që lidhen me sindromën Tourette. Pirja e duhanit nuk rekomandohet nga prodhuesi, dhe metodat e preferuara të përdorimit përfshijnë thithjen nga një avullues dhe infuzion në çaj. Në teori çdo mjek mund të përshkruajë kanabis mjekësor, por në praktikë vetëm një numër i kufizuar e bëjnë këtë. Që nga marsi 2015, rreth 1 200 pacientë e marrin kanabisin mjekësor, me recetë të mjekut, përmes farmacisë. Nuk ka asnjë rimbursim nga sistemi kombëtar i kujdesit shëndetësor, por mund të ketë një rimbursim të pjesshëm nga sigurimi shëndetësor suplementar (EMCDDA, 2018). Në Republikën Çeke, Agjencia Shtetërore për Mjekësi Kanabisi u krijua si një departament i veçantë i Instituti Shtetëror të Kontrollit të Barnave. Ka vendosur rregulla për recetë elektronike, farmaci e kështu me radhë, por një regjistër i posaçëm regjistri filloi të funksionojë vetëm në nëntor 2014. Përdorimi i produkteve mjekësore të kanabisit dhe parashkrimet mbi mënyrën e përdorimit dhe nivelin e THC-së (deri në 21 %) janë të mundura vetëm në përputhje me Njoftimin e Ministrisë së vitit 2013. Fillimisht limitet e pacientit ishin 30 gram në muaj, por u rritur në 180 gram në muaj në tetor 2015. Aktualisht vetëm 16 mjekë të kualifikuar posaçërisht, si onkologë dhe psikologë, janë të autorizuar të përshkruajnë kanabis, dhe vetëm 26 farmaci mund ta japin atë. Pacientët duhet të jenë të moshës mbi 18 vjeç. Korrja e parë shtëpiake ishte shpërndarë nëpër farmaci në mars 2016, me çmim për pacientin rreth 3.70 euro/gram ndërkohë që çmimi mesatar i kanabisit të paligjshëm në Republikën Çeke ishte rreth 7.40 euro/gram në 2014) (EMCDDA, 2018).

Në Itali, Ministria e Shëndetësisë është organi koordinues për kanabis mjekësor. Nga nëntori 2015, ministria mund të lëshojë leje për kultivim, prodhim, posedim dhe përdorim, dhe kanabisi bimor mund të jepet me një recetë një përdorimëshe. Vlen të theksohet se përdorimi i kanabisit është vetëm për trajtim simptomatik që mbështet trajtimet standarde, ku rezultatet nuk mund të arrihen me trajtimet tradicionale. Kushtet e pranueshme janë kryesisht spasticiteti, dhimbje kronike, të përziera nga kimioterapia ose trajtimet e HIV, humbja e oreksit nga kanceri ose SIDA, glaukoma dhe sindroma Gilles de la Tourette. Fermerët e licensuar e dorëzojnë kanabisin në ministri, e cila më pas e ndan për prodhim. Farmacisti

blen aktivin substancë nga ministria me kupona, dhe përgatit magjistrale (përgatitjet në përputhje me rrethanat). Mjekët duhet të përshkruajnë shtamin gjenetik më të përshtatshëm, shpërndarjen, sasinë dhe mënyrën e konsumimit për çdo pacient (EMCDDA, 2018).

Në Kroaci, rregulloret e reja hynë në fuqi në tetor 2015 në kuadër të të cilave ndryshoi urdhëri për klasifikimin, përshkrimin dhe shpërndarjen e barnave, për të lejuar përdorimin e kanabisit për qëllime mjekësore. Duke ndjekur rekomandime të nxjerra nga ekspertë të neurologjisë, sëmundjeve infektive ose specialistë të kancerit, barna që përmbajnë THC, dronabinol ose nabilone mund të jepen nga mjekët e përgjithshëm apo mjekët e familjes me receta një përdorimshe. Këto ilaçe mund të jenë të përshkruara për të lehtësuar simptomat e sklerozës së shumëfishtë, kancerit, epilepsisë dhe SIDA-s. Ato mund të jenë në forma të ndryshme, të tilla si çajra, pomada dhe ekstrakte të tjera duke përfshirë preparate galenike; pirja e duhanit ose avullimi i kanabisit bimor nuk lejohet. Receta duhet të tregojë shumën e THCsë në një dozë të vetme, numrin e dozave individuale, formën, dozimin dhe mënyrën e përdorimit të barit; gjithashtu nëse është e aplikueshme lloji i barnave bimore dhe preparati bimor i cili do përfshihet në përbërjen kryesore. Barnat që përmbajnë THC mund të përshkruhen në sasinë e nevojshme për trajtim deri në 30 ditë. Sasia totale e THC-së e përshkruar në 30 ditë trajtim nuk duhet të jetë më e madhe se 7.5 gram (EMCDDA, 2018).
Në Evropë ka akoma vende që kanë një legjislacion të ngurtësuar lidhur me liberalizimin e kanabisit, por ka edhe shumë shtete që kanë sjellë rezultate pozitive nga liberalizimi i tij, për shembull në Portugali, e cila ka qenë shteti i parë i cili ka riparë qëndrimin e tij në fushën e lëndëve narkotike. Më saktësisht që nga viti 2001 ka përjashtuar nga ndjekja penale posedimin duke adoptuar një politikë të përqendruar në mbrojtjen e individit dhe jo në dënimin e konsumatorëve. Duke mbajtur këtë qëndrim, Portugalia sot është konsideruar vendi i katërt më i sigurt në botë sipas Global Peace Index, numri i të dënuarve për vepra penale në fushën e lëndëve narkotike ka rënë nga 4000 persona në 1000 persona aktualisht. Në përgjithësi, përdorimi i të gjitha substancave narko tike ka pësuar një rënie të lartë. Në Spanjë në fakt legjislacioni ka lënë hapësira ku e lë përdorimin e kanabisit në mënyrë të lirë, pasi në vende të mbyllura kanabisi është i lejuar, ndërsa në hapësira publike është i dënueshëm me gjobë. Gjithashtu lejohet mbjellja në ambientet e banimit, por në sasi të vogla. Në Holandë kanabisi nuk është i legalizuar, por ekziston politika legale e tolerancës, në fakt shitja në përgjithësi mbetet e jashtëligjshme, por nuk aplikohet nëpër kafene dhe duhet të respektohen kritere të mirëpërcaktuara, si për shembull minorenëve nuk mund t'u shiten më shumë se 5 gram kanabis të njëjtit person (Petruccelli, M., 2021).

E drejta ndërkombëtare nuk parandalon përdorimin e kanabisit ose produkteve me bazë kanabisi si ilaç për trajtimin e indikacioneve të përcaktuara. Sipas konventave të OKB-së, barnat nën kontrollin ndërkombëtar duhet të kufizohen në "qëllime mjekësore dhe shkencore". Neni 28 i Konventës së 1961 përshkruan një sistem kontrollesh të kërkuara nëse një vend vendos të lejojë kultivimin e kanabisit që nuk është për qëllime industriale ose kopshtare, ndërsa Konventa e 1971 kontrollon THC. Në vendet evropiane, barnat e autorizuara mund të përfshijnë THC në kapsula, ekstrakt kanabisi si llak për gojë dhe lule të thata kanabisi për avullim ose për të bërë "çaj".
Në të kundërt, asnjë vend nuk autorizon pirjen e duhanit të kanabisit për qëllime mjekësore. Ka dy arsye kryesore për këtë. Së pari, ka shumë lloje të bimëve të kanabisit dhe secili varietet ka kapacitetin për të prodhuar një sërë kimikatesh. Gama dhe përqendrimi i kimikateve mund të ndryshojnë gjithashtu brenda një bime, për shembull në varësi të niveleve të dritës gjatë rritjes ose pjekurisë në korrje. Nëse këta faktorë nuk kontrollohen rreptësishtë, është shumë e vështirë për një mjek dhe farmacist të gjykojë përmbajtjen dhe rrjedhimisht dërgimin e kimikateve të veçanta të nevojshme për pacientin. Së dyti, thithja e tymit nga djegia e materialit bimor nuk është një metodë e shëndetshme për dërgimin e këtyre kimikateve në qarkullimin e gjakut, pasi pacienti do të thithë gjithashtu katranë dhe grimca të dëmshme. Kur kimikatet e kërkuara nuk janë psikoaktive, siç është CBD, është gjithashtu shumë e vështirë për përdoruesin të masë saktë dozën.

4. Rregullimi Institucional dhe Ligjor në Shqipëri

Përsa i përket legjislacionit penal në Republikën e Shqipërisë në fushën e lëndëve narkotike, neni 283/1 I Kodit Penal përcakton se:

Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim pesë deri në dhjetë vjet.

Legjislacioni në fushën penale aktualisht nuk e parashikon specifikisht sasinë e lëndës narkotike që duhet të konsiderohet si dozë për përdorim vetjak. Pra, në interpretim të normës së mësipërme, rasti i vetëm përjashtimor i ndjekjes penale nga organi i akuzës është vetëm kur kemi të bëjmë me doza të vogla të cilat janë vetëm për përdorim vetjak.

Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 1, datë 27.03.2008: "Përcaktimi i sasisë së lëndës narkotike për përdorim personal" ka interpretuar në arsyetimin e tij se duhet të jetë eksperti i fushës i cili duhet të vlëresojë se sa do të jetë në gramaturë doza për përdorimin vetjak. Gjithashtu, për përcaktimin e dozave, gjykata bazohet edhe në disa elemente të tjerë siç janë:

1.Lloji i lëndës narkotike
2.Sasia e lëndës narkotike që mund të përodoret nga një person pa i shkaktuar dëme anësore.
3.Shkalla e varësisë së personit nga lënda narkotike;
4.Sasia e gjetur shërben për një përdorim, apo më shumë.

Shtetëror të Kontrollit të Barnave. Ka vendosur rregulla për recetë elektronike,

Qeveria Shqiptare duke pasur si qëllim goditjen dhe luftën e krimit të organizuar dhe ndalimin e trafikimit të lëndës narkotike të kanabisit, ka miratur me Vendim Nr. 248, datë 29.03.2017 "Për Miratimin e Planit të Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017–2020". Qëllimi kryesor i këtij plani veprimi është hartimi i një plani të ri kombëtar kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit të diktuar nga nevoja për parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kësaj dukurie, me përfshirjen në këtë plan të një sërë institucionesh të administratës publike. Ndër qëllimet kryesore të këtij vendimi është goditja dhe shkatërrimi i rrjeteve të kultivimit dhe të trafikimit të lëndëve narkotike, reduktimi i përdorimit të kanabisit, si dhe krijimi i mundësive për zhvillim të qëndrueshëm në komunitetet dhe zonat e prekura. Objektivat kryesorë të këtij lani janë: goditja dhe reduktimi i kultivimit dhe goditja dhe shkatërrimi i rrjeteve të trafikimit.

Për arritjen e qëllimeve të vendosura në Vendimin Nr. 248 janë krijuar edhe figura të reja institucionale ku në krye të përpjekjes shtetërore për parandalimin dhe goditjen e kultivimit, përdorimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike është Komiteti Ndërministror (KN) me pjesëmarrjen e ministrave dhe zyrtarëve të tjerë të lartë. Misioni i këtij komiteti është miratimi i politikave dhe vendimeve të rëndësishme, përcaktimi i përparësive, akordimi i burimeve financiare dhe materiale, si dhe drejtimi i veprimtarisë së Task-Forcës Qendrore (TFQ). TFQ-ja është një strukturë operacionale në nivel qendror e cila

koordinon, orienton dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave qendrore dhe vendore të Përgjithshëm të FA-së dhe të strukturave të tjera që kanë detyrime në kuadër të këtij plani.ngarkuara me zbatimin e këtij plani. TFQ funksionon përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së këtij plani. Detyrat e TFQ-së përfshijnë koordinimin operacional në nivel qendror, analizat e përbashkëta të gjendjes, matjen dhe vlerësimin e suksesit të strukturave të ngarkuara me zbatimit të këtij plani, si dhe mbështetjen e tyre me mjetet e nevojshme. Në përbërje të TFQ-së janë përfaqësues të Policisë së Shtetit, të Prokurorisë, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, të Drejtorisë së Hetimit Doganor, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe të strukturave të tjera që kanë detyrime në kuadër të këtij plani.

Në nivel vendor ngrihen dhe funksionojnë Task-Forcat vendore (TFV) në përbërje të të cilave janë përfaqësues lokalë të institucioneve të përfaqësuar në TFQ, përfaqësues të pushtetit vendor dhe të bashkive. Krijimi i një fondi qeveritar për të financuar programet mbështetëse për banorët e zonave rurale të rrezikuara nga përfshirja në veprimtari të paligjshme, është instrumenti që mundëson jetësimin e objektivave të kësaj strategjie. Fondi krijohet nga kontributi i qeverisë, i autoriteteve vendore dhe i donatorëve.

Pikat e përcaktuara në këtë plan veprimi janë si më poshtë:

a) Identifikimi, parandalimi, zbulimi, dokumentimi, goditja dhe shkatërrimi i grupeve kriminale;
b) Parandalimi i përfshirjes së qytetarëve në kultivimin e kanabisit, nëpërmjet përdorimit të kombinuar të masave shtrënguese ligjore dhe programeve të zhvillimit ekonomik;
c) Njohja dhe raportimi në kohë i situatës lidhur me kultivimin e kanabisit;
d) Shtimi i sipërfaqes së mbjellë me bimë bujqësore që përshtaten me kushtet e zonave të rriskuara, zgjerimi i aktiviteteve të tjera të ligjshme dhe rritja e numrit të të punësuarve, duke zvogëluar njëkohësisht mundësinë e shfrytëzimit të tyre për qëllime kriminale;
e) Identifikimi i sipërfaqeve të mbjella me kanabis dhe atyre potenciale për t'u mbjellë;
f) Verifikimi i funksionarëve që rezultojnë se nuk kanë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrën, për goditjen e kultivimit dhe trafikimit, i atyre që i janë nënshtruar gjendjes së paligjshmërisë nëpërmjet përfshirjes në këtë aktivitet dhe ndarjes së fitimeve të siguruara nga kjo veprimtari e paligjshme;
g) Përqendrimi i përpjekjeve kryesore te parandalimi i mbjelljes dhe shkatërrimi i fidanëve;
h) Shënjimi dhe shkatërrimi i grupeve kriminale të organizuara, të përfshira në trafikimin e kanabisit (financuesit, organizatorët, trafikantët e drogës, ndërlidhësit, kultivuesit, shpërndarësit);
i) Shtimi i kapaciteteve të kontrollit të kufirit për të parandaluar trafikimin e lëndëve narkotike; Intensifikimi i kontrolleve policore dhe doganore, për zbulimin e narkotikëve, përfshirë dhe farërat e kanabisit; Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me vendet e origjinës së farërave dhe destinacionit të narkotikëve; Adaptimi i një qasje specifike (zbulimi, teknikat, taktikat dhe procedurat) për luftën ndaj kontrabandës;
j) Përmirësimi i kapaciteteve të mbikëqyrjes ajrore me qëllim monitorimin e territorit shqiptar dhe zbulimin e sipërfaqeve të mbjella me kanabis, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët/agjencitë ndërkombëtare;
k) Rritja e kapaciteteve të specializuara shëndetësore me qëllim që t'u përgjigjen sa më mirë nevojave të pacientëve që trajtohen për problemet e varësisë nga droga;
l) Përditësimi i njohurive të mësimdhënies/nxënies për çështjen e kanabisit nëpërmjet zgjerimit dhe kompletimit të kurrikulave;
m) Mirorganizimi, menaxhimi dhe përdorimi i shërbimeve të ofruara nga interneti për përfshirjen më të gjerë të publikut në çështjen e luftës kundër kanabisit;
n) Reduktimi i kërkesës së tregut të brendshëm nëpërmjet uljes së numrit të përdoruesve;
o) Hartimi dhe zbatimi i një plani të integruar të informimit dhe të komunikimit i cili synon shkëmbimin efektiv të informacionit ndërmjet strukturave të përfshira në zbatimin e PKKK-së me publikun e gjerë;
p) Përcjellja e njohurive të sakta te qytetarët, nëpërmjet burimeve të besueshme, për efektet negative dhe dëmet që shkakton përdorimi i kanabisit dhe lëndëve të tjera narkotike;
q) Përfshirja e rubrikës "Droga" në aplikacionin "Komisariati Dixhital" me qëllim denoncimin e rasteve të lidhura me kanabisin dhe drogat e tjera;
r) Rritja e dialogut dhe partneritetit me të gjithë aktorët për të adresuar bashkërisht problematikat e kultivimit të kanabisit, pasojat e konsumimit dhe trafikimit të drogës;

s) Krijimi dhe vënia në funksion e një strukturave koordinuese dhe drejtuese ndërinstitucionale në nivel qendror;
t) Sigurimi i informacioneve me vlerë mbi veprimtarinë e individëve dhe/ose grupeve kriminale, të përfshirë në kultivimin e kanabisit dhe trafikimin e lëndëve narkotike, nëpërmjet krijimit të mundësive për aktivizimin e sinjalizuesve;
u) Rritja e burimeve njerëzore, financiare, teknike dhe operative të angazhuara kundër kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të kanabisit, nëpërmjet përfshirjes së një numri të gjerë institucionesh;
v) Zgjerimi i bashkëpunimit me aktorë të tjerë në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar në interes të shkëmbimit të informacionit dhe të goditjes së fenomenit të kanabisit;
w) Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet strukturave ligjzbatuese për zbatimin efektiv të nenit 10/1 të ligjit, "Për barnat narkotike dhe substancat psikotrope".

Përsa i përket plotësimit të kuadrit ligjor, legalizimi i kanabisit për përdorimin mjekësor në Shqipëri do të sillte ndryshime të mëdha, së pari në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe në vijim në ligjet e posaçme, si dhe aktet nënligjore që do të miratoheshin në funksion të këtij ligji të posaçëm lidhur me kushtet teknike që do të duhet të plotësonin shoqëritë që do të operonin në këtë sektor, mënyrën dhe sasinë e cila do të duhej të kultivohej, etj.
Aktualisht në Republikën e Shqipërisë është i lejuar kultivimi i kërpit (Cannabis sativa L) për qëllime industriale për prodhimin e fibrave dhe të farërave vetëm për varietetet që përmbajnë jo më shumë se 0,1% THC, kjo për sa parashikon Ligji Nr.9271, datë 9.9.2004 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7975, Datë 26.7.1995 'Për Barnat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope'".

5. Analiza të Situatave në Tërësi në Vende të Tjera që e Kanë Legalizuar Procesin më Parë

Sipas Ogrodnik, M., et al (2015), kanabis është droga më e përdorur në nivel botëror me rreth 180 milionë përdorues. Pavarësisht se kanabisi është kultura më e zakonshme e drogës ilegale në botë shumë pak dihet për prodhimin, tregtimin dhe konsumin e saj në shkallë globale në mënyrë legale dhe ilegale. Kjo është kryesisht për shkak të ndalimit global për më shumë se një shekull dhe rreziqeve që lidhen me kërkimin e prodhimit të paligjshëm të bimëve të drogës. Gjithashtu, të dhënat e kufizuara të disponueshme në lidhje me kultivimin e kanabisit janë shpesh të pasakta, jo të besueshme dhe shumë të diskutueshme. Ndërsa kjo ka qenë gjithmonë problematike, për sa i përket njohurive të plota dhe politikëbërjes, tani është bërë edhe më sensitive pasi tendencat botërore drejt dekriminalizimit dhe legalizimit kërkojnë të vlerësohen pasojat pozitive dhe negative në vendet prodhuese dhe përdoruese. Madhësia e tregut global të kultivimit të kanabisit u vlerësua në vlerën 323.9 miliardë dollarë për vitin 2021 dhe pritet të zgjerohet me një normë rritjeje vjetore prej 21.4% nga 2022 në 2030. Kërpi dhe marijuana tashmë konsiderohen produkte bujqësore të prodhuara në mënyrë ligjore në mbi 40 vende. Vende të tilla si Kina, Kanadaja, Franca, Kili, Koreja e Jugut, Ekuador, Kroacia, Republika Çeke, Mongolia, Rumania dhe Rusia janë disa nga prodhuesit kryesorë në të gjithë botën (New Frontier Data, 2022).

Sipas rajoneve gjeografike, Amerika e Veriut dominon tregun për kultivimin e kanabisit për sa i përket pjesës së të ardhurave të përfituara në vitin 2021 për shkak të përmirësimit të shpejtë të ligjeve në lidhje me kultivimin dhe përdorimin e kanabisit dhe zhvillimin ekonomik. Për më tepër, reformat në rritje të qeverisë që mbështesin kultivimin e kërpit dhe marijuanës në rajon ka të ngjarë të nxisin rritjen e mëtejshme gjatë periudhës së parashikimit. Evropa renditet rajoni i dytë në botë për prodhimin e kërpit.

Azia Lindore gjithashtu pritet të shfaqë rritje fitimprurëse. Rritja e ndërgjegjësimit për kanabisin dhe përfitimet e tij mjekësore, rritja e grupit të pacientëve të kualifikuar për trajtime mjekësore me marijuanë, prania e tregjeve më të mëdha të kultivimit në rajon dhe kushtet e favorshme klimatike janë disa nga faktorët kryesorë që nxisin rritjen e tregut (New Frontier Data, 2022).
Legalizimi në rritje dhe adoptimi i kanabisit për trajtimin e sëmundjeve kronike janë faktorët kryesorë që nxisin rritjen e tregut. Përveç kësaj, liberalizimi i ligjeve që lidhen me kultivimin e kanabisit, veçanërisht për kultivimin e kërpit nga vende të ndryshme për shkak të përmbajtjes së ulët të THC-së, po e rrit më tej miratimin e tij. Për më tepër, legalizimi i marijuanës në territore të ndryshme dhe adoptimi në rritje i saj për qëllime mjekësore janë faktorë që nxisin tregun për kultivimin e kanabisit. Për shembull, që nga prilli 2021, 35 shtete dhe Distrikti i Kolumbisë e kanë legalizuar marijuanën për qëllime mjekësore, së bashku me 16 vende që lejojnë të rriturit të përdorin këtë substancë për qëllime rekreative. Midis këtyre shteteve, Kalifornia, Uashingtoni dhe Kolorado janë shitësit kryesorë të kanabisit. Nivelet e prodhimit të kanabisit në Amerikën e Veriut janë rritur me shpejtësi gjatë viteve të fundit për shkak të zgjerimit të kapaciteteve prodhuese të kompanive të licensuara. Më shumë shtete mendohet se do të ndjekin të njëjtin shembull duke marrë parasysh kërkesën

e përhapur për kanabis dhe vetitë e tij mjekësore. Kjo shifër është e sigurt që do të rritet pasi më shumë individë i afrohen konceptit të legalizimit të marijuanës në të gjithë SHBA-në dhe botën.

Figura 1: Tregu i shitjes së kanabisit në SHBA (në milionë dollarë)



Burimi: Hemp Business Journal, 2021, *parashikime

Kolorado është në një moment historik të prodhimit të marijuanës, duke tejkaluar një miliardë dollarë të ardhura shtetërore që kur legalizoi drogën në 2014. Deri në maj të këtij viti, shteti ka parë më shumë se 6 miliardë dollarë në shitje totale të marijuanës që kur industrisë i'u dha drita jeshile. Kolorado ka 2,917 biznese të licencuara të marijuanës dhe 41,076 njerëz të licencuar për të punuar në kwtw industri (Hemp Industry Outlook, 2021).

Tregu i kanabisit në BE përfaqëson një total prej 31% të të gjithë tregut të kanabisit në botë, duke u renditur i dyti vetëm pas Amerikës së Veriut. Tregu i kanabisit në Evropë është më pak i pjekur se në SHBA dhe Kanada. Pikat e shitjes gjithnjë e më shumë në territoret e sapo legalizuara janë bërë një nga tendencat më të mëdha në metropolet evropiane kryesore në dekadën e fundit. Evropa duket se ka mësuar shumë nga SHBA-ja dhe Kanadaja. Ndërsa industria e SHBA-së ka vuajtur nga paqartësitë ligjore që rrjedhin nga përshtatshmëritë rregullatore mbarëkombëtare midis ligjeve federale dhe shtetërore, Evropa ka pasur mundësinë të krijojë një industri më të unifikuar me një numër në rritje të organizatave evropiane si Shoqata Evropiane e Kërpit Industrial, Rrjeti Evropian i Advokimit të Kanabisit i sapokrijuar nga vetë BE-ja (Graphical Research, 2021).

Mbi 90,000 hektarë tokë në kontinentin evropian i dedikohen prodhimit të kërpit, e cila përbën 25% të prodhimit botëror, shumica e të cilave janë të përqendruara në Francë, Holandë, Itali dhe Rumani. Kjo është në mënyrë eksponenciale më e madhe se 8,000 hektarë që i'u dedikuan kultivimit të kërpit në 2011.

Figura 2: Prodhimi i kërpit në Evropë (në hektar)



Burimi: New Frontier Data, 2019

Në fund të vitit 2021, tregu evropian i kanabisit u vlerësua të ishte pothuajse 4,550 milionë dollarë, ndërsa vlera e parashikuar e tregut për fundin e 2027 është 25,883 milionë dollarë (Statista, 2020).

Figura 3: Tregu i shitjes së kanabisit në Evropë (në milionë dollarë)

Burimi: Statista, 2021, *parashikime

Shteti më i ri i cili ka legalizuar prodhimin e kanabisit në Evropë është Maqedonia e Veriut. Në maj 2016, Maqedonia e Veriut miratoi Ligjin për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope, i cili lejon prodhimin e kanabisit dhe produkteve të kanabisit për përdorim mjekësor, dhe eksportin e nxjerrjes së kanabisit medicinal. Deri në vitin 2019 janë dhënë 61 licenca për kultivimin e kanabisit dhe katër licenca për nxjerrjen e kanabisit. Qeveria e Maqedonisë së Veriut pret që biznesi i kultivimit të kanabisit të jetë "shumë fitimprurës", të krijojë më shumë vende pune dhe të rrisë PBB-në e vendit me rreth 250 milionë euro në vit duke shpresuar se vendi do të ndjekë shembullin e Amsterdamit për të zhvilluar një industri të “turizmit të kanabisit” (Dmitrievska, V., 2021).

Një tjetër risi e rëndësishme në projektligj është detyrimi i kompanive të licencuara që merren me kultivimin e kanabisit për qëllime mjekësore që të paguajnë 10% të fitimit neto në një fond të posaçëm në buxhetin e shtetit. Fondet do të përdoren për projekte me interes publik, si për mbështetjen e personave me sëmundje të rralla, fondin mediatik, punën e agjencisë së planifikuar, si dhe aktivitete sportive, kulturore dhe të shoqërisë civile (Dmitrievska, V., 2021).

Kërkesa e lartë për kanabis mjekësor ka çuar në një pamjaftueshmëri në zinxhirët e furnizimit në vende të ndryshme. Kjo është kryesisht për shkak të rritjes së konsiderueshme të kërkesës dhe kufizimit të kultivimit në vende të ndryshme (Kelly, E. et al 2020). Sipas hulumtimit të publikuar në The Lancet (2021) pandemia COVID-19 rezultoi në 53.2 milionë raste shtesë të rëndësishme të çrregullimeve depresive dhe 76.2 milionë raste të tjera të çrregullimeve të ankthit në mbarë botën në vitin 2020. Hulumtimi i publikuar në Journal of Addictive Diseases (2020) zbuloi një rritje të përdorimit të kanabisit mjekësor. Studimi vlerëson se pacientët me probleme të shëndetit mendor e rritën përdorimin e tyre të kanabisit mjekësor me 91% kur COVID-19 u shpall pandemi më 11 mars 2020. Vazhdimi në kohë i koronavirusit dhe konfliktet e rënduara gjeopolitike që kanë sjellë pasoja në mbarë botën, mund të mbajë përdorimin e marjuanës lartë në mesin e pacientëve të shëndetit -mendor.

6. Analiza e Situatës në Shqipëri

Kultivimi i kanabisit në Shqipëri daton disa dekada më parë, që me rënien e sistemit komunist ku të dhënat e para datojnë që nga fillimet e viteve 1990' kur Shqipëria doli nga një periudhë izolimi 45-vjeçare e imponuar nga regjimi komunist. Ndryshimi i shpejtë nga shteti i centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë, i cili u shoqërua me mbylljen e fabrikave shtetërore dhe fermave kolektive, çoi në nivele të larta papunësie, duke i lënë shqiptarët me mundësi të reduktuara për të fituar jetesën. Disa i'u drejtuan kultivimit të kanabisit, i cili shihej si një burim i lehtë dhe fitimprurës të ardhurash, duke e bërë kështu kultivimin e tij një burim të hershëm të punësimit sezonal (Mejdini, F. et al, 2019).

Deri në vitin 2000, ishin zhvilluar linjat e krijuara të kontrabandës brenda rajonit, në Turqi, por edhe në vendet e tjera evropiane, veçanërisht në Itali dhe Greqi, të cilat konsiderohen edhe si rrugë kalimi për në vendet e tjera të Evropës Perëndimore. Ndërmjet viteve 2000 dhe 2014, industria e kultivimit masiv me rritje të shpejtë tërhoqi punëtorë nga i gjithë vendi, shumë prej tyre gra, aq sa në disa zona të vendit ka pasur mungesë oferte për punë për profesione si punëtorë ndërtimi, elektricistë, hidraulikë apo të ngjashme. Çmimi i kanabisit arriti në rreth 600-700 Euro/kg në vitin 2014. Kultivimi i kanabisit kulmin e përjetoi rreth vitit 2016, deri në pikën që pati një mbingopje të tregut nga shtimi i prodhuesve dhe trafikantëve të kanabisit, ku madje edhe punëtorët e grupeve kriminale krijuan grupet e tyre të vogla të prodhimit dhe shpërndarjes. Vetëm në zonën e Lazaratit, mendohet të jetë prodhuar 900 ton kanabis në 2016, me një vlerë neto prej rreth 4.5 miliardë euro.

Mediatizimi ndërkombëtar i bumit të kultivimit dhe shpërndarjes edhe në vende të tjera të rajonit dhe Evropës sidomos dhe trysnia nga institucionet ndërkombëtare, veçanërisht në kuadër të integrimit të vendit në BE, ndikuan rëndësishëm në ndërmarrjen e operacioneve policore për shkatërrimin e rrënjëve të kanabisit si përpjekje për të frenuar prodhimin në Shqipëri. Nga njëra anë masat e marra nga qeveria dhe nga ana tjetër rritja e konkurrencës ndërmjet prodhuesve çoi në ulje të çmimit deri në 150 Euro/kg (Mejdini, F. et al, 2019).

Dy vitet pasuese patën një rënie të dukshme të prodhimit të kanabisit, por 2019 duket se shënon një pikë kthimi për tregun ilegal, ku kanabisi tregtohej me një çmim prej 1000 Euro/kg. Kjo mund të shihet si një tregues i faktit që aktorët kyç në këtë treg janë ende aktivë.

Interesante është gjetja e studimit të Mejdani, F. et al (2019) se pas vitit 2016, eksporti ilegal është përqendruar kryesisht në Turqi, destinacion i arritur nëpërmjet rrugëve detare, ku kanabisi me një çmim prej rreth 3000 Euro/kg shkëmbehet me heroinën me një çmim prej rreth 9000 Euro/kg për t'u rishitur në Shqipëri te grupe të tjera kriminale me një çmim që varion 13000 – 15000 Euro/kg.

Në mënyrë të vazhdueshme janë identifikuar të mbjella në territorin e Shqipërisë dhe janë kapur në flagrancë gjatë transportit sasi të konsiderueshme të kanabisit, në operacione të ndërmarra nga ana e Policisë së Shtetit Shqiptar, por edhe në bashkëpunim me forcat e rendit italiane (Guardia di Finanza) dhe atyre greke (Hellenic Police), duke bërë që në media të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare Shqipërisë ti jepet

një vëmendje e veçantë. Gjithsesi, edhe sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme ndër vite, kanabisi nuk është e vetmja lloj lënde narkotike që ka qarkulluar dhe është kapur në flagrancë në Shqipëri; sasi të konsiderueshme janë trafikuar edhe të kokainës dhe heroinës.[3]

Në Figurën 4 paraqitet sasia e marijuanës së sekuestruar në Shqipëri nga autoritetet policore përgjatë viteve 2014-2021. Vihet re se sasia më e madhe e sekuestruar e marijuanës në vend i përket vitit 2014 me 97.1 ton, vit ku aktiviteti i kultivimit të kanabisit ishte konsoliduar nga grupet kriminale. Pavarësisht lulëzimit të aktivitetit, sekuestrimet në vitin pasues ranë me 88.23%. Mediatizimet dhe trysnia e ndërkombëtarëve shtoi operacionet e çrrënjosjes dhe shkatërrimit të plantacioneve dhe nga ana tjetër, edhe shtimi i bashkëpunimit me organet homologe fqinje për kapjen e sasive që hyjnë kontrabandë dhe shfrytëzojnë pozicionin gjeografik të Shqipërisë për kalime jashtë vendit, bëri që në dy vitet pasuese të kishte një rritje të sasisë së sekuestruar të marijuanës. Kështu, në vitin 2017, masat e sekuestruara të marijuanës pësuan një rritje prej 48.29 ton në vlerë nominale ose një rritje prej 161.83%.

Figura 4. Sasia e Marijuanës e Sekuestruar nga Autoritetet Policore në Shqipëri (në ton)



Burimi: Ministria e Brendshme, 2022 dhe përpunim i të dhënave nga autorët

Grafiku tregon se pas vitit 2017, masat e sekusetruara kanë qenë në nivele relativisht më të ulëta krahasuar me periudha më parë, duke arritur minimumin e kësaj periudhe në vitin 2020 me 2.78 ton marijuanë të sekuestruar. Në vitin e fundit vihet re përsëri një rritje në sasi me 0.7 ton përafërsisht, por që në fakt përbën mbi 25% të vlerës së një viti më parë.

E gjithë faza nga prodhimi i kanabisit deri të shitja për konsumatorin final të kanabisit, sikurse dhe të çdo lloj tjetër lënde narkotike për vendet qe nuk e kanë dekriminalizuar apo/dhe legalizuar atë, lidhet me ekonominë informale dhe me pastrimin e parave. Ekonomia informale në Shqipëri luhatet rreth vlerave 30-40% të ekonomisë në tërësi, ku për vitin 2017, studimi i Reitano, T. et al (2020) bazuar mbi vlerësimet e Ernst and Young tregon që ekonomia gri në Shqipëri kap vlerën 18% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), ndërsa ekonomia e paligjshme vlerën e 22% të PBB-së. I njëjti studimi tregon se trafiku i drogës është fitimprurësi më i rëndësishëm për grupet kriminale në Shqipëri me 70–90% të Flukseve Financiare të Paligjshme në vend të krijuara pikërisht nga trafiku i drogës. Gjithashtu, po sipas këtij studimi, bazuar në vlerësimin e MONEYVAL, trafiku i drogës është burimi kryesor i parave të pastruara në Shqipëri, duke zënë 42% të të gjithë rasteve të pastrimit të parave.

Një fenomen i shoqëruar me kultivimin ilegal të kanabisit është edhe korrupsioni. Punonjësit e policisë së shtetit, duke filluar nga efektivë të thjeshtë e deri të persona në nivele të larta drejtuese duket se janë bërë pjesë e këtij aktiviteti ilegal në Shqipëri nëpërmjet tolerimit të rasteve të kultivimit e deri në lehtësimin e trafikimit për përfitime financiare personale nëpërmjet marrjes së ryshfeteve. Raste të tilla janë denoncuar dhe bërë pjesë e çështjeve gjyqësore, madje ka pasur edhe denoncime nga gazetarë për dhunë që është ushtruar kundrejt tyre nga ana e policëve në raste denoncimesh të korrupsionit dhe ryshfeteve (Mejdani, F. et al,

3 URL: https://mb.gov.al/raporti-mujor/

2019) Përfshirja e strukturave policore apo e strukturave të tjera shtetërore në aktivitetet ilegale lidhur me kanabisin përkthehet nga njëra anë si faktor ndikues në zhvillimin dhe përhapjen e tyre dhe nga ana tjetër si një nga pasojat negative dhe të drejtpërdrejta që këto aktivitete kanë.

Sipas Transapency International, organizatës udhëheqëse të shoqërisë civile që lufton korrupsionin në mbarë botën, Indeksit i Perceptimit të Korrupsionit (CPI) me të dhënat e përditësuara në Qershor 2022, për Shqipërinë është mesatarisht 31.38 pikë nga viti 1999 deri në vitin 2021, duke arritur një nivel të lartë historik prej 39 pikësh në 2016 dhe një rekord të ulët prej 23 pikësh në 1999.

Figura 5 në fakt tregon që gjatë periudhës për të cilën studimet dhe raportet tregojnë se aktivitetet e lidhura me kanabisin në Shqipëri kanë lulëzuar, CPI ka pasur një trend rritës, pra ka pasur një perceptim të përmirësimit të situatës.

Figura 5. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit për Shqipërinë, 1999-2021



Burimi: Transparency International, 2022

Vlerën më të lartë të periudhës së marrë në shqyrtim, CPI e merr në 2016, pikërisht në atë që mendohet se ka qenë piku i aktivitetit ilegal.

Ndërkohë, pas këtij viti, Indeksi tregon për një rritje të korrupsionit të perceptuar në Shqipëri.

[4] CPI përgjithësisht e përkufizon korrupsionin si "shpërdorim i pushtetit politik për përfitime personale" dhe vlerësimet rezultojnë nga anketimi drejtuar ekspertëve dhe biznesmenëve dhe bazohet kryesisht në lidhjet midis korrupsionit, lirisë së shtypit dhe rënies së lirive civile në mbarë botën. CPI rendit vendet dhe territoret bazuar në atë se sa i korruptuar perceptohet se është sektori i tyre publik në një shkallë nga 0 (shumë i korruptuar) deri në 100 (shumë i pastër).

7. Përfitimet dhe Risqet e Mundshme që Vijnë nga Legalizimi i Kanabisit për Arsye Mjekësore në Shqipëri

Në të gjithë botën, vendet që kanë legalizuar përdorimin e kanabisit për arsye mjekësore janë më të shumta në numër se vendet qe e kanë legalizuar atë për përdorim rekreativ. Në Shqipëri, tema e legalizimit të kanabisit mjekësor është rihapur në kuadër të nismës së Këshillit Kombëtar të Qeverisë Shqiptare. Qytetarët janë pyetur nëse janë pro apo kundër legalizimit të kultivimit, përpunimit dhe eksportit të kanabisit për arsye mjekësore dhe nga 563,195 qytetarë që kanë plotësuar pyetësorin, rezultoi se 61% e e tyre janë pro nismës, 29% kundër, dhe pjesa tjetër prej 10% nuk kanë shprehur asnjë qëndrim (Këshillimi Kombëtar, 2022).

Kryeministri i Shqipërisë, është shprehur se aktualisht, qeveria shqiptare është duke u konsultuar me shumë vende të OECD-së për mënyrën se si funksionon kjo strategji në vendet evropiane. Nëse prodhimi i kanabisit do të legalizohet, do të bëhet vetëm për qëllime mjekësore, duke e eksportuar atë në vende të tjera. I gjithë procesi do të zhvillohet nën kontroll të rreptë: do të ketë subjekte të licencuara dhe impiantet do të monitorohen me kamera.

Legalizimi i kanabisit, pavarësisht se vetëm për arsye mjekësore, për një vend si Shqipëria të njohur ndërkombëtarisht për këtë lloji aktiviteti ilegal, krijon një dilemë, pasi si çdo çështje tjetër delikate, shoqërohet me përfitime dhe rreziqe të mundshme. Disa nga ekspertët thonë se legalizimi zgjidh problemet e paligjshmërisë apo veprimtarive të paligjshme. Mund të ndihmojë gjithashtu qeverinë në aspektin financiar, veçanërisht pas tërmeteve të vitit 2019 dhe dëmeve të pandemisë COVID-19 nëpërmjet mbledhjes së taksave nga aktiviteti. Gjithashtu, një përfitim i mundshëm është rritja e punësimit formal dhe rënia e atij informal. Nga ana tjetër, ka ekspertë të ekonomisë, të cilët shprehen se informaliteti që ekziston në vend e bën të pamundur menaxhimin e situatës. Legalizimi i kanabisit për momentin është i rrezikshëm për ekonominë dhe bujqësinë. Keqmenaxhimi farmaceutik mund të çojë në një rritje të numrit të përdoruesve dhe gjithashtu mund të rrisë rrezikun e një tregu të zi paralel të kanabisit. Bujqësia shqiptare mund të rrezikojë shndërrimin e saj në një monokulturë kanabisi për shkak të joshjes nga përfitimet e larta. Disa nga ekspertët në intervistat e dhëna e vlerësuan këtë iniciativë si një presion që i bëhet qeverisë nga bota e krimit. Bizneset që do të drejtojnë të gjithë procesin, duke filluar nga mbjellja e deri tek eksportimi i kanabisit, mund të jenë nën presionin e grupeve të organizuara kriminale.

8. Gjetjet Kryesore

Igjithë procesi i prodhimit dhe tregtimit të kanabisit deri te konsumatorët finalë duket se tërheq grupe të ndryshme, duke filluar që nga fermerët e thjeshtë që mbjellin disa rrënjë në vend të kulturave të zakonshme, te grupet e të papunëve dhe veçanërisht të të rinjve që joshen nga fitimet e larta e deri te grupet e organizuara kriminale që bashkëpunojnë me grupet e huaja dhe mundësojnë shitjen te shpërndarësit apo konsumatorët finalë në pjesën tjetër të botës.

Gjithsesi, dekriminalizimi apo legalizimi i kanabisit, pavarësisht qëllimit, mund te jetë i suksesshëm për disa vende, sikurse për të tjera mund të jetë një vendim politik i gabuar.

Bazuar në analizën e vendeve të botës, tregu i kanabisit është në rritje e sipër. Një e pjesë e madhe e vendeve e prodhojnë dhe e lejojnë përdorimin e tij për qëllime të ndryshme dhe sipas vlerësimeve, më shumë vende do të vijojnë sipas vlerësimeve, më shumë vende do të vijojnë lehtësimin e legjislacioneve përkatëse për të rritur përdorimin. Si rezultat, kërkesa e lartë po përballet me pamjaftueshmërinë e ofertës. Në këtë kontekst, futja në tregun e kanabisit si prodhues dhe eksportues mund të jetë një mundësi e mire për të rritur të ardhurat kombëtare.

Por kjo nuk e mbyll diskutimin, më shumë kërkime nevojiten: qeveritë dhe akademikët duhet të investojnë më shumë në kërkimin se cilat modele politikash janë më efektive në reduktimin e dëmeve të lëndëve narkotike në përgjithësi dhe të kanabisit në veçanti dhe arritjen e rezultateve të drejta dhe të shëndetshme të politikave. Të dhëna më të shumta dhe më të mira do të forcojnë kërkimin ekzistues dhe do të ofrojnë një bazë të shëndoshë mbi të cilën do të ndërtohen dhe hartohen politikat e drogës në të ardhmen.

Referenca

-ADF (Alcohol and Drug Foundation), 2019: *"Cannabis legalisation: what model for regulation?"* URL: https://adf.org.au/insights/cannabis-legalisation

-Bloom, A., 2018: *"What Is the Difference Between Medical and Recreational Marijuana?"* URL: https://docmj.com/difference-medical-recreational-marijuana/

-David, B-T. et al, 2016: *"Cannabis regulation and the UN drug treaties"*

-DEA (Drug Enforcement Administration), 2020: *"Drug Fact Sheet"* URL: https://www.dea.gov/sites/default/files/2020-06/Marijuana-Cannabis-2020_0.pdf

-Desjardins, J., 2019: *"The 6,000-Year History of Medical Cannabis"* URL: https://www.visualcapitalist.com/history-medical-cannabis-shown-one-giant-map

-Dimitrievska, V., 2021: *"North Macedonia expects cannabis cultivation"*, BNE IntelliNews

-EMCDDA (European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction), 2018: *"European Drug Report: Trends and Development"* URL: https://www.emcdda.europa.eu/publications/edr/trends-developments/2018_en

-FindLaw (2021): *"Marijuana Legalization and Decriminalization Overview"* URL: https://www.findlaw.com/criminal/criminal-charges/marijuana-legalization-and-decriminalization-overview.html

-Graphical Research, 2021: *"Europe Cannabidiol (CBD) Market Forecast 2027 by Route of Administration"*,

-Hemp Business Journal, 2021: "The CBD Report: Hemp Industry Outlook"

-Langlois, C. et al, 2021: *"The Lancet Journal: Maintenance or Discontinuation of Antidepressants in Primary Care"*

-Lewis, G. et al, 2020: *"Journal of Addictive Diseases: Down and High: Reflections Regarding Depression and Cannabis"*

-Mejdini, F. et al, 2019: *"Growing like weeds? Rethinking Albania's culture of cannabis cultivation"* URL: https://globalinitiative.net/analysis/growing-like-weeds-rethinking-albanias-culture-of-cannabis-cultivation/

-Ministria e Brendshme, 2013-2022: Raporte Statistikore Mujore të Ministrisë së Brendshme Aksesuar më: 06.06.2022. URL: https://mb.gov.al/raporti-mujor/

-Ogrodnik, M. et al, 2015: *"An economic analysis of different cannabis decriminalization scenarios"*

-Kelly, E et al, 2020: *"The economic and cultural importance of cannabis production to a rural place"*

-Këshillimi Kombëtar, 2022: *"Rezultatet e Këshillimit Kombëtar" URL: https://keshillimikombetar.al/pdf/Rezultatet%20e%20Keshillimit%20Kombetar2.pdf*

-Kodi Penal i Republikës së Shqipërië, Neni 283 "Prodhimi dhe Shitja e Narkotikëve"

-Kwai, I., 2020: *"U.N. Reclassifies Cannabis as a Less Dangerous Drug"*, The New York Times

-Ligji Nr.9271, datë 9.9.2004 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7975, datë 26.7.1995 'Për Barnat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope'"*

-Petruccelli, M., 2021: *"La Cannabis in Europa: In Quali Paesi è Legalle Consumare Cannabis"* URL: https://megliolegale.it/la-cannabis-in-europa/

-Powell, B., 2018: *"The 7 Countries with the Strictest Weed Laws"*, High Times

-Reitano, T. et al, 2020: *"Illicit Financial Flows in Albania, Kosovo and North Macedonia: Key drivers and Current Trends"* URL: https://globalinitiative.net/analysis/iffs-western-balkans/

-Rosmarin, A. et al, 2012: *"A Quiet Revolution: Drug Decriminalisation Policies in Practice Across Globe"* URL: https://www.opensocietyfoundations.org/publications/quiet-revolution-drug-decriminalisation-policies-practice-across-globe#publications_download

-Roojin, H. et al, 2018: *"Legalizing Cannabis Violates the UN Drug Control Treaties, But Progressive Countries Like Canada Have Options"*. Ottawa Law Review.

-Statista - The statistics portal for market data market research and market studies: https://www.statista.com/
-New Frontier Data - Cannabis Business Intelligence: https://newfrontierdata.com/
-Vendim Nr. 248, datë 29.3.2017 *"Për Miratimin e Planit të Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017–2020"*
-Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 1, datë 27.03.2008 *"Përcaktimi i sasisë së lëndës narkotike për përdorim personal"*

Aneks

Tabela 1. Sasia e Marijuanës e Sekuestruar nga Autoritetet Policore në Shqipëri (në ton)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
2022	0.13	0.18											0.31[5]
2021	0.06	0.09	0.10	0.05	0.38	0.07	0.07	1.00	0.33	0.49	0.22	0.62	3.48
2020	0.28	0.10	0.63	0.12	0.35	0.16	0.20	1.08	0.78	0.33	0.01	0.20	2.78
2019	2.00	1.31	0.49	0.32	0.46	0.06	0.41	0.23	0.31	0.55	0.04	0.08	6.26
2018	4.06	1.25	3.68	2.16	1.49	2.76	0.71	1.50	0.59	0.50	0.92	0.77	9.59
2017	1.79	6.0	6.15	20.30	4.33	3.36	18.04	2.47	5.74	5.80	3.08	1.07	78.13
2016	0.24	0.75	0.44	0.19	0.16	0.69	1.35	0.89	4.90	7.34	10.02	2.87	29.84
2015	0.19	0.02	0.13	0.02	0.14	0.07	0.12	0.25	2.70	5.2	2.24	0.35	11.43
2014	3.58	3.5	3.97	5.18	3.45	66.41	5.26	1.99	0.61	1.6	1.42	0.13	97.1

Burimi: Ministria e Brendshme, 2022 dhe përpunim i të dhënave nga autorët[6]

[5] Të dhënat për vitin 2022 janë publikuar vetëm për muajt Janar-Shkurt

[6] Të gjitha të dhënat në tabelë janë marrë nga raportet mujore të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme, Aksesuar më: 06.06.2022. URL: https://mb.gov.al/raporti-mujor/

Fondacioni Qemal Stafa

www.fqs.al
secretary@fqs.al